

SHABAN DEMIRAJ – KRISTAQ PRIFTI**KONGRESI I ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE DHE VENDI
I TIJ NË KULTURËN SHQIPTARE***

Kanë kaluar 100 vjet që nga koha kur atdhetarët e shquar rilindës mbajtën në Manastir Kongresin e alfabetit, i cili i dha rrugëzgjdhje njërit prej problemeve më të vështira e më të rëndësishme të shoqërisë shqiptare, njësimin të alfabetit të gjuhës shqipe. Duke e vlerësuar këtë ngjarje nga largësia e një shekulli të tërë, mund të pohojmë, pa asnjë ngurrim, se vendimet e atij Kongresi për alfabetin e gjuhës shqipe do të mbeten përgjithmonë në historinë e kombit tonë si arritja më e madhe në jetën kulturore të shqiptarëve në shek. XX, me një ndikim të fuqishëm në zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës e të kulturës së tyre. Me vendimet e Kongresit të Manastirit shqiptarët i treguan botës se tanimë ishin konsoliduar si një komb unik dhe se ushqenin një aspiratë të përbashkët, të hynin në rrugën e përparimit kulturor, shoqëror dhe ekonomik dhe të zinin vendin, që u takonte si popull europian në familjen e madhe të kombeve të qytetëruar të Europës.

Kongresi i alfabetit kurorëzoi me sukses përpjekjet e bëra gjatë shekujve për të përsosur sistemin grafik të gjuhës shqipe, për të përpunuar një alfabet sa më të përshtatshëm për shkrimin e shqipes nga të gjithë shqiptarët. Rëndësia e madhe e atij tubimi mbarëshqiptar kuptohet më natyrshëm, po të kihet parasysh se gjuha shqipe, e dokumentuar me shkrim edhe më herët se shekulli XVI, kur u botuan “Meshari” i Gjon Buzukut dhe “E mbësuaame e krështerë” e Lukë Matrangës, gjatë shekujve pasardhës ishte shkruar me alfabete të ndryshme, gjë që jo vetëm pengonte zhvillimin e përgjithshëm të popullit shqiptar, por ishte bërë edhe një faktor përçarjeje dhe mosmarrëveshjeje midis shqiptarëve. Kështu, edhe në një qytet me tradita kulturore, siç ishte Shkodra në fillim të shekullit XX, përdorehin për shkrimin e gjuhës shqipe katër lloje alfabetesh: alfabeti tradicional i shkrimtarëve të vjetër katolikë të Veriut, alfabeti i Shoqërisë “Bashkimi” (1899), alfabeti i Shoqërisë “Agimi”

* Bashkëreferat i mbajtur në konferencën shkencore *Kongresi i Manastirit dhe njësimi i alfabetit të gjuhës shqipe*, Tiranë, 17 nëntor 2008.

(1902) si edhe alfabeti arab. Kurse në pjesët jugore të trevave shqiptare përdorej kryesisht alfabeti i Stambollit (1879) dhe aty-këtu edhe alfabeti grek. Nga ana tjetër, arbëreshët e Italisë kishin në përdorim kryesisht alfabetin e De Radës. Nuk po përmendim këtu alfabetet e përdorura nëpër botime të ndryshme në gjuhën shqipe para vitit 1908 në vende të ndryshme.

Detyrën e njësimimit të abëcësë së shqipes i takoi ta zgjidhte epokës së Rilindjes, që zuri një shekull të tërë të historisë së popullit shqiptar (shek. XIX-fillimin e shek. XX). Gjatë Rilindjes, falë përpjekjeve të brezave të tërë dijetarësh, shkrimtarësh e publicistësh, kombi shqiptar njohu një zhvillim të paparë e pasurim të mëtejshëm të mendimit politik e kulturor kombëtar, të gjuhës dhe të letërsisë shqipe. Kjo periudhë u karakterizua nga forcimi i përpjekjeve për përsosjen e shkrimit të gjuhës shqipe, por ato përpjekje u shoqëruan njëherazi edhe me shtimin e numrit të alfabeve, që përdoreshin për shkrimin e kësaj gjuhe. E kjo e vështirësoi edhe më tepër detyrën e vendosjes së një alfabeti të vetëm për gjuhën shqipe, e cila, përgjithësisht, për shkak të rrethanave politike-shoqërore në të cilat ndodhej Shqipëria e robëruar, paraqitej tepër e ndërlikuar, krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit. Te popujt e tjerë, procesi i njësimimit të alfabetit u zhvillua si pjesë e një kulture të lëvruar prej kohësh dhe të përpunuar në kushte legale nga iluministët e Rilindjes europiane dhe ballkanike. Ndryshe u zhvillua ai në Shqipëri, ku në kushtet e sundimit osman mungonin institucionet kulturore e shtetërore kombëtare, ndalohej me çdo mjet mësimi dhe shkrimi i gjuhës amtare shqipe dhe ndiqej një politikë shkombëtarizuese e pashembullt, si nga pushtuesi, ashtu edhe nga shtetet fqinje, që përpiqeshin t'i shkombëtarizonin shqiptarët dhe të gllabëronin trojet e tyre.

Në këto rrethana, vendosja e një alfabeti të vetëm, përhapja e shkrimit shqip me anë të shkollave shqipe dhe lëvrimi i një letërsie sa më të pasur në gjuhën amtare, nuk trajtoheshin nga rilindësit vetëm si çështje kulture, por edhe në rrafshin politik si veprime patriotike, që do të ndihmonin për forcimin e unitetit kombëtar dhe të bashkimit politik të popullit shqiptar, pa të cilët nuk mund të arrihej çlirimi i atdheut nga robëria e huaj. Por përvoja e përpjekjeve për një alfabet të njëjtë për gjuhën shqipe u tregoi gjithashtu shqiptarëve se zgjidhja e kësaj çështjeje do të varej nga zhvillimi i lëvizjes kombëtare në përgjithësi.

Mendimtarët rilindës ishin gjithashtu të ndërgjegjshëm se vendosja e një alfabeti të përbashkët për gjuhën shqipe nuk pengohej vetëm nga sundimtarët e huaj, por edhe nga prirjet separatiste e përçarjet në çështjen

e alfabetit të gjuhës shqipe, të cilat rridhnin nga interesat lokale të shoqërive dhe grupeve kulturore shqiptare që qëndronin pas alfabeteve të ndryshme e që ushqeheshin nga ndasitë krahinore të trashëguara nga thellësitë e shekujve. Këto prirje nuk u mënjanuan as pas miratimit të Alfabetit (alfabetares) të Stambollit në vitin 1879, që u hartua me përpjekjet e Sami Frashërit, Jani Vretos, Pashko Vasës, Kostandin Kristoforidhit, Hasan Tahsinit etj. Me këtë alfabetare, ndonëse u bë një hap i rëndësishëm përpara në rrugën e vendosjes së një alfabeti të përshtatshëm, çështja e njësimimit të alfabetit të shqipes nuk u zgjidh përfundimisht. Alfabeti i Stambollit u përhap kryesisht në Shqipërinë e Jugut e të Mesme, kurse në Shqipërinë e Veriut e veçanërisht në Shkodër, siç u përmend edhe pak më sipër, në prag të mbledhjes së Kongresit të Manastirit ishin në përdorim katër alfabete. Edhe organet e shtypit shqiptar, kontributi i të cilave në lëvizimin e gjuhës shqipe ishte i madh, ndonëse botoheshin të gjitha me alfabetin latin, kishin ndryshime ndërmjet tyre.

Mendimtarët rilindës, si Sami Frashëri, Andon Z. Çajupi, Faik Konica, Mithat Frashëri, Hilë Mosi, Aleksandër S. Drenova, Shahin Kolonja, Aleksandër Xhuvani, Fan Noli, Ndre Mjeda, Mati Logoreci, Loni Logori, Sotir Peci, Jeronim de Rada, Xh. Skiroi, etj., në artikujt e botuar në shtypin shqiptar në vitet 1897–1908, nuk u pajtuan me këtë shumëllojshmëri alfabetesh, duke e quajtur atë një dukuri përçarëse e të dëmshme për unitetin e kombit shqiptar. Ata u bënë thirrje gjithë shoqërive gjuhësore dhe “shkronjësve” të gazetave shqipe, që të “arrinin një marrëveshje” e “të pranonin një alfabet të njëjtë për shkrimin e shqipes”¹. U bënë gjithashtu propozime për ta vënë këtë problem në rrugën e zgjidhjes, duke thirrur një kuvend ose kongres për të vendosur “me shumicën e zërave” një alfabet të përbashkët për shqiptarët².

¹ *Albania*, Bruksel, nr. 7, 1897, “Puna e letrave”, artikull i redaksisë; *Shqipëria*, Bukuresht, nr. 44, 15 qershor 1898, “Për alfabetnë”, artikull i redaksisë; A. Ç. Zacia (Çajupi), “Për alfabetnë”, në: *Shqipëria*, Bukuresht, nr. 49, 31 gusht, 1898, nr. 50; 15 shtator 1898; nr. 51, 1 tetor, 1898; nr. 52, 15 tetor 1898, nr. 53, 1 nëntor 1898; *Ylli i Shqipërisë*, Bukuresht, nr. 3, 1898, “Kombi dhe gjuha”, artikull i redaksisë, *Shqipëria*, Magaga (Egjipt), nr. 4, 5 maj 1907, *Dy fjalë për Abenë*, artikull i redaksisë.

² *Shqipëria*, Magaga (Egjipt), nr. 4, 5 maj, 1907, “Dy fjalë për Abenë”, artikull i redaksisë.

Pikërisht në këtë kohë, në pragun e Kongresit të Manastirit mjaft nga personalitetet e kulturës shqiptare shpallën botërisht në shkrimet e tyre se shqiptarët, duke qenë një komb i veçantë dhe europian, duhej “të shkonin në një udhë të rrahur nga gjithë kombet e qytetëruara...”, të zgjidhnin alfabetin latin³, i cili njihej nga gjithë bota, i përshtatej më tepër natyrës së gjuhës shqipe dhe krijonte mundësi më të mëdha teknike për botimin e librave dhe lëvrimin e letërsisë shqipe.

Kongresi i Manastirit, që mori përsipër ta zgjidhte përfundimisht detyrën e njësimin të alfabetit të gjuhës shqipe, i zhvilloi punimet e tij më 14–22 nëntor të vitit 1908, në kushtet e reja e të favorshme politike që u krijuan për lëvizjen kulturore kombëtare pas fitores së Revolucionit xhonturk të vitit 1908 dhe shpalljes së Kushtetutës, ngjarje në të cilat shqiptarët dhanë një ndihmesë të veçantë. Klubi “Bashkimi” i Manastirit, që ishte kryesori ndër klubet shqiptare dhe nismëtar i thirrjes së Kongresit të abëcësë shqipe dhe drejtuesit e klubeve dhe të shoqërive të tjera kulturore, që e përkrahën këtë nismë, e vlerësonin njësimin e alfabetit si një nga detyrat më të ngutshme politike-kombëtare të kohës. Ata shkruanin në letërkëmbimin e tyre se “alfabeti unik provon se kombi ynë është bërë një si komb”, se “ai do të ndihmojë edhe në përparimin e vendit tonë në fushën ekonomike, në industri, tregti etj.”⁴.

Pikërisht, sepse hapte këto perspektiva, sepse u ngarkua të përballonte këto detyra të mëdha të kohës, nisma e Klubit “Bashkimi” të Manastirit, u mbështet nga klubet e tjera, si nga ato të Elbasanit, Janinës, Shkupit, Shkodrës, Beratit, Starovës, Ohrit, Strugës, Tetovës, Gostivarit, si edhe nga kolonitë shqiptare jashtë atdheut. Kjo përkrahje ishte një lloj garancie për thirrjen e Kongresit dhe për suksesin e punimeve të tij.

Kongresi i Manastirit u bë një kuvend i vërtetë mbarëshqiptar, në të cilin morën pjesë 50 delegatë nga të gjitha qytetet e Shqipërisë, si edhe nga shoqëritë patriotike shqiptare të Sofjes, Bukureshtit, Konstancës, Amerikës, Egjiptit, Italisë etj.

Delegatë të tij ishin disa nga shkrimtarët dhe publicistët më të njohur, lëvrues të shquar të letërsisë dhe të gjuhës shqipe, laikë e klerikë, si Gjergj Fishta, Mithat Frashëri, Nikollë Kaçorri, Ndre Mjeda, Gjergj Qiriazi, Hilë Mosi, Mati Logoreci, Luigj Gurakuqi, Shahin Kolonja,

³ *Shqipëria*, Bukuresht, nr. 49-53, 1898; *Shqipëria*, Magaga (Egjipt), nr. 5, 15 qershor 1907.

⁴ *Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi: Klubi “Bashkimi” i Manastirit dos. 5, 7; Fondi: Th. Gërmenji, dos. 12.

Fehim Zavalani, Sotir Peci, Thoma Avrami, Adam Shkaba; veprimtarë të njohur të lëvizjes kombëtare dhe të klubeve shqiptare, si Bajram e Çerçiz Topulli, Mihal Gramenoja, Dhimitër Mole, Nyzhet Vrioni, Lef Nosi, Dhimitër Buda, Simon Shuteriqi, Rrok Berisha (Gjakovë), Leonidha Naço, Rauf Fico (Gjirokastër), Shefqet Frashëri, Refik Toptani, Sami Pojani, Gligor Cilka, Emin bej Shkupi, Hafiz Ibrahim (Shkup), Ramiz Beu (Dibër), Xhemal Beu (Ohër), Fahri Frashëri (Resnjë), Salahedin Beu (Manastir) etj. Kryetar i Kongresit u zgjodh Mithat Frashëri, ndërsa nënkryetarë Luigj Gurakuqi dhe Gjergj Qiriazhi⁵.

Megjithatë, duhet pranuar gjithashtu se Kongresi i Manastirit nuk arriti të tërhiqte të gjithë intelektualët më të përgatitur në çështjen e gjuhës shqipe e të alfabetit të saj. Sikurse vinte në dukje në një nga raportet e tij Gjergj Qiriazhi, nënkryetar i Klubit “Bashkimi” të Manastirit, nënkryetar i Kongresit dhe anëtar i Komisionit të alfabetit, “shumica e njerëzve të ditur të Shqipërisë, që dëgjuan për këtë Kongres, mendonin se nuk ishte koha për një gjë të këtillë dhe shumë prej tyre erdhën vetëm sa për të qenë të pranishëm, pa pritur ndonjë përfundim të mirë”⁶. Por punimet e Kongresit dhe rezultatet e tij treguan se rruga që zgjodhën atdhetarët e intelektualët e shquar për zgjidhjen e problemit të alfabetit duke thirrur një kuvend kombëtar, ishte më e drejta. Historia provoi se vepra e kryer në Kongresin e Manastirit i qëndroi kohës, u bë pjesë e pandarë e kulturës shpirtërore të kombit shqiptar. Edhe Gj. Qiriazhi shkruante në po atë relacion se “rezultatet e mira të Kongresit provuan se ata që mendonin ndryshe, qenë të gabuar”⁷.

Gjithsesi, kryesia e Kongresit, e ndërgjegjshme se çështja e alfabetit, për shkak të specifikës së saj, kërkonte angazhimin e njerëzve më të përgatitur në lëmin e gjuhësisë, ngarkoi për zgjidhjen e saj një Komision prej 11 vetash, të kryesuar nga Gjergj Fishta dhe të përbërë prej përfaqësuesish të alfabeteve të ndryshme dhe prej intelektualësh të tjerë. Zgjedhja e Gjergj Fishtës në krye të këtij Komisioni pati një rëndësi të veçantë për mbarëvajtjen e punimeve të tij. Atë Gjergj Fishta nuk ishte atëherë as më i moshuari (ishte vetëm 37 vjeç) dhe as më i përgatituri nga

⁵ Shaban Demiraj - Kristaq Prifti, *Kongresi i Manastirit*, Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 84, 156-157.

⁶ *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archives Albanien* (më tej: *HHSt.A, PA, A*), Manastir, 20 janar 1909, “Raport i Kongresit shqiptar, mbajtur në Manastir, 1/14 nëntor 1908”.

⁷ *Po aty*.

ana filologjike midis njëmbëdhjetë anëtarëve të komisionit, por ishte një poet i talentuar dhe me emër. Për më tepër, në një nga mbledhjet e hapura të Kongresit Fishta i bëri për vete delegatët e Kongresit me fjalën e tij të zjarrtë, që Gjergj Qiriazi e quajti “një bisedë të shkëlqyer”. Edhe pse ishte përfaqësues i shoqërisë “Bashkimi” dhe i alfabetit të saj, Fishta u shpreh i gatshëm të pranonte alfabetin e përbashkët, që do të vendosej në Kongres. “Unë, – tha ai, – nuk kam ardhur të mbroj ndonjërin nga këto alfabete, por kam ardhur të bashkohem me ju dhe të adoptoj atë alfabet, të cilin do ta vendosë Kongresi si më të dobishmin për ngritjen e popullit”. Ai e quajti mungesën e një alfabeti të përbashkët një humbje të madhe për shqiptarët dhe shprehu në këtë fjalim vendosmërinë për t’i gjetur patjetër një zgjidhje këtij problemi shqetësues.

Kongresi dha pëlqimin paraprak që vendimi i Komisionit për çështjen e alfabetit të ishte përfundimtar dhe i detyrueshëm për të gjithë delegatët.

Komisionit iu desh të kapërcente vështirësi të mëdha për zgjidhjen e çështjes së alfabetit, jo vetëm për shkak të shumëllojshmërisë së alfabeteve që ishin në përdorim deri në atë kohë, por edhe për shkak të pranisë në atë Komision të përfaqësuesve të alfabeteve kryesore: të Gjergj Fishtës, përfaqësues i alfabetit të shoqërisë “Bashkimi”; Ndre Mjedës, përfaqësues i alfabetit të shoqërisë “Agimi”; dhe të Mithat Frashërit etj., përfaqësues të alfabetit të Stambollit. Është e vërtetë se të tri këto alfabete mbështeteshin në alfabetin latin, por ndryshonin në mënyrën e plotësimit të shkronjave që i mungonin atij alfabeti; madje, ndryshonin edhe në vlerat fonetike, me të cilat i kishin përdorur disa shkronja latine.

Për të kapërcyer mosmarrëveshjet, Komisioni vendosi të mos merrej në vështirësi asnjëri nga të tri alfabetet e lartpërmendura, por të krijohej një alfabet i ri mbi bazën e alfabetit latin, duke u dhënë shkronjave latine vlera fonetike në përputhje me nevojat e gjuhës shqipe. Të gjitha shkronjat latine u shqyrtuan me kujdes dhe u pranuan, duke bërë ndryshime në vlerën fonetike të disave prej tyre. Por lidhur me shkronjat e nevojshme për ata tinguj të shqipes, që i mungonin latinishtes, si *dh, gj, ll, nj, sh, th* etj., komisioni e pati të vështirë të merrte një vendim të përbashkët, prandaj u detyrua të hiqte dorë nga kjo përpjekje dhe nga synimi për të hartuar një alfabet të ri. Në vendimin e Kongresit thuhej se arsye të shtynte delegatët të hiqnin dorë nga krijimi i një alfabeti krejt të ri mbi bazën e alfabetit latin, qenë vështirësitë për të

përcaktuar karakterin e shkronjave dyshe (dh, gj, ll, nj, sh, th etj.), me të cilat do të shpreheshin disa tinguj të shqipes.

Në rrethana të tilla, anëtarët e Komisionit, duke e parë se ishte e pamundur të binin në ujdë për shkronjat e diskutueshme të një alfabeti të ri dhe “të shtyrë edhe nga disa shkake të jashtme”, siç pohohet në Rezolutën e Kongresit, vendosën që “të kthehen prapa”, duke pranuar alfabetin e Stambollit me disa ndryshime jo të parëndësishme e “bashkë me të edhe një abecë fjesht latine që të mësohen e të përdoren bashkërisht në mest të shqypstarëve”⁸.

Me shkaqe të jashtme, që i detyruan anëtarët e Komisionit të miratonin edhe një alfabet thjesht latin, kuptohej, siç u shpall në mbledhjen e hapur të Kongresit më 20 nëntor, lehtësia e shtypjes së librave jashtë vendit me alfabetin latin. Por nga relacioni i Gjergj Qiriazit me titull “Raport i Kongresit shqiptar, mbajtur në Manastir më 1/14 nëndor 1908” dhe në mënyrë të veçantë nga përgjigjja që ai i jep pyetjes “Përse u zgjodhën dy alfabete?”, nxjerrim përfundimin se “me shkaqe të jashtme” duhen kuptuar jo vetëm ato teknike, lehtësitë e shtypshkrimit në Europë me alfabetin thjesht latin, por edhe trysnia e ndikimi që kanë ushtruar mbi Komisionin qarqet dhe shoqëritë e ndryshme shqiptare, që përkrahnin alfabetin e Stambollit në Shqipërinë e Jugut dhe atë të “Bashkimit” në Gegëri e sidomos në Shkodër⁹.

Komisioni arriti të gjente rrugëdaljen nga kjo gjendje e ndërlikuar, duke miratuar dy alfabete, atë të Stambollit dhe një alfabet thjesht latin. Kjo është meritë e të gjithë anëtarëve të komisionit e në mënyrë të veçantë e kryetarit të tij, Gjergj Fishtës, i cili, megjithëse ishte përfaqësues i Shoqërisë “Bashkimi”, ka luajtur një rol të rëndësishëm në vendosjen e kësaj fryme mirëkuptimi. Fishta duhet të ketë ndikuar gjithashtu edhe për krijimin e alfabetit të dytë me shkronja thjesht latine, të plotësuar me anë dyshkronjëshash, ashtu si në alfabetin e “Bashkimit”.

Vendimi i Komisionit për alfabetin e gjuhës shqipe u shpall më 20 nëntor në mbledhjen e hapur të delegatëve të Kongresit, që e miratuan atë njëzëri.

⁸ *Vendimi i Komisionit mbi çështjen e Abecesë*, Manastir, 7/20 vjeshtë e tretë, 1908, në: Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi: Klubi “Bashkimi” i Manastirit”, Dosje nr. 2, dok. nr. 2.

⁹ *HHSSt.A, PA, A*, Manastir, 20 janar 1909, “Raport i Gjergj Qirjazit për Kongresin e Manastirit”, f.11.

Duhet theksuar se alfabeti i dytë thjesht latin, i vendosur nga Komisioni i Kongresit, nuk është i njëjtë me atë “të Bashkimit”, siç është pandehur apo thënë nga disa. Këto dy alfabete ndryshojnë midis tyre në *njëmbëdhjetë* shkronja dhe pikërisht në shkronjat *c, ç, e, ë, gj, nj, q, x, xh, z, zh*. Kjo do të thotë se Komisioni i të Njëmbëdhjetëve, kur është shtruar çështja për të caktuar edhe një alfabet të dytë krahas atij të Stambollit, nuk ka bërë një punë të përciptë, duke adoptuar automatikisht alfabetin e “Bashkimit”. Përkundrazi, të dhënat që kemi, dëshmojnë se Komisioni duhet të ketë diskutuar gjatë si për këtë alfabet të dytë, ashtu edhe për përmirësimin e mëtejshëm të alfabetit të Stambollit, duke i bërë edhe atij disa ndryshime.

Vendimi i Kongresit të Manastirit për abëcënë shqipe shënoi një hap të rëndësishëm përpara në rrugën e zgjidhjes përfundimtare të njësimin të alfabetit; ai ishte një fitore e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, që ushtroi ndikim të madh në forcimin e mëtejshëm të bashkimit politik dhe në përparimin kulturor të kombit shqiptar. Me këtë vendim iu dha fund kaosit që mbretëronte deri atëherë në çështjen e shkrimit të shqipes. Numri i alfabeve që do të përdornin shqiptarët paskëta, u pakësua në dy dhe këta i ngjanin shumë njëri-tjetrit, duke qenë se që të dy kishin si bazë alfabetin latin. Për më tepër, sipas vendimit të Kongresit, të dy alfabetet do të përdroreshin “bashkarisht”.

Por duhet pranuar se vendimi i Kongresit të vitit 1908 për çështjen e alfabetit, nuk ishte një zgjidhje përfundimtare. Gjithsesi, duke ia lënë kohës mënjanimin e njërit prej të dy alfabeve, ai vendim e përmbante në vetvete edhe zgjidhjen e shpejtë përfundimtare të problemit të alfabetit. Gjergj Qiriazi, duke shprehur edhe mendimin e delegatëve të Kongresit, shkruante në relacionin e tij: “Brenda këtyre dy vjetëve, para se të mblidhet kongresi tjetër, do të kuptohet se cili [alfabet] do të përdoret më shumë dhe ai do të adoptohet si alfabet kombëtar”¹⁰. Dhe kjo nuk vonoi të realizohej. Alfabeti i Stambollit, me gjithë përparësinë, që kishte në përfaqësimin e çdo tingulli të gjuhës shqipe me një shkronjë të vetme, paraqiste vështirësi për botime nëpër shtypshkronja që nuk i kishin shkronjat e posaçme të tij. Prandaj u mënjaua shpejt nga përdorimi, kështu që aty nga fundi i Luftës së Parë Botërore mbeti në përdorim vetëm alfabeti thjesht latin, që u vendos si alfabet i dytë në Kongresin e Manastirit. E këta njëqind vjet që kanë kaluar, kanë

10 Po *aty*.

dëshmuar se ky alfabet i ka plotësuar fare mirë kërkesat e një gjuhe të shkruar në zhvillim të pandërprerë.

Alfabeti që kemi sot në përdorim, ashtu si alfabeti i Stambollit, është mbështetur në parimin *një shkronjë: një tingull* e ky parim është zbatuar si për shkronjat e thjeshta ashtu edhe për shkronjat e përbëra *ll, rr, nj, gj, th, dh, sh, zh, xh*. Por ai edhe është kritikuar, se në disa raste nuk e plotëson më së miri këtë kërkesë. Këtu është fjala për mosdallimin shkrimor të tinguj-shkronjave *nj* nga *n-j*, *gj* nga *g-j*, *dh* nga *d-h*, *th* nga *t-h*, *sh* nga *s-h* dhe *zh* nga *z-h*, në raste të tilla, si *zonjë* dhe *qen-je*, *lagje* dhe *djeg-je*, *e madhe* dhe *Mid-hat*, *i thatë* dhe *Et-hem*, *moshë* dhe *mos-hapje*, *zhabë* dhe *Maz-har* etj. Me përjashtim të rasteve të tipit *Mid-hat*, *Et-hem* dhe *Maz-har*, që janë emra të përveçëm prej burimi të huaj dhe që janë fare të paktë, në rastet e tjera kemi të bëjmë me fjalë të prejardhura, ku bashkimi i tingujve [n] dhe [j], [g] dhe [j], [s] dhe [h] ndodh në kufi të morfemave dhe për këto raste Drejtshkrimi i Gjuhës Shqipe ka gjetur një zgjidhje, duke këshilluar që *j* pas *n-* e *g-* të shkruhet me *i*, si p.sh.: *qenie*, *djegie* etj. Vetëm për rastet e tipit *mos-hapje* nuk kemi ndonjë zgjidhje, por këto raste janë fare të pakta dhe nuk përbëjnë ndonjë problem. Për sa u takon emrave të përveçëm të tipit *Mid-hat*, *Et-hem*, *Maz-har* etj., në praktikë vihet re prirja për t'i shqiptuar e për t'i shkruar ata thjesht *Midat*, *Etem*, *Mazhar* etj. Gjithsesi, këto raste nuk e vënë në pikëpyetje saktësinë e alfabetit tonë të mbështetur në parimin *një shkronjë: një tingull*. Në këtë rast nuk do të ishte e tepërt të kujtojmë se vështirësi të tilla, madje edhe më të shumta e më të mëdha, bien në sy edhe në shkrimin e disa gjuhëve të tjera me tradita shkrimore më të vjetra se shqipja, si p.sh. në anglishte, gjermanishte, italishte, frëngjishte etj. Të kihet parasysh, p.sh., se në gjuhët e lartpërmendura shkronjat *c* dhe *g* shqiptohen ndryshe kur ndiqen nga një zanore e përparme dhe ndryshe kur ndiqen nga një zanore tjetër apo nga një bashkëtingëllore. Gjithashtu, vlen të përmendet se në ato gjuhë bien në sy vështirësi më të mëdha edhe në drejtshkrimin e disa fonemave, që herë jepen me dy a më shumë shkronja e herë me një shkronjë të vetme.

Gjykuar në tërësinë e tij, Kongresi i Alfabetit i vitit 1908 është vlerësuar me të drejtë si një nga ngjarjet më të rëndësishme të historisë së re të popullit shqiptar dhe të kulturës shqiptare në veçanti, si një ngjarje që e çoi më tej lëvizjen kombëtare shqiptare në fillim të shekullit XX e që ushtroi një ndikim të fuqishëm në zhvillimin e kulturës kombëtare shqiptare gjatë atij shekulli e më pas.

Theksojmë me këtë rast se fryma e mirëkuptimit dhe e bashkëpunimit që karakterizoi të gjithë delegatët e Kongresit, pa dallim krahine dhe feje, dëshmoi qartë se shqiptarët dinë t'i kapërcejnë dasitë dhe të gjejnë një gjuhë të përbashkët kur përpiqen të ngrihen mbi pikëpamjet e ngushta krahinore e vetjake, për t'i shërbyer një çështjeje të përgjithshme kombëtare. Ky është një nga mesazhet më kuptimplotë që na ka përcjellë Kongresi i Alfabetit i vitit 1908.

Kongresi i Manastirit nuk mbeti një mbledhje thjesht gjuhësore. Ai përpunoi e miratoi gjithashtu një program politik kombëtar prej 18 pikash, që iu dha deputetit të Korçës, Shahin Kolonjës, për ta paraqitur në parlamentin turk në emër të shqiptarëve¹¹. Ky program përbën një nga dokumentet më të rëndësishme të Kongresit të Manastirit dhe të lëvizjes kombëtare të periudhës së parë pas Revolucionit Xhonturk. Ndonëse nuk shtrohej haptazi kërkesa e autonomisë së Shqipërisë, në programin e Kongresit të Manastirit parashtroheshin një varg kërkesash, që do të çonin dora-doras në realizimin e saj. Vendin kryesor e zinin kërkesat për “njohjen zyrtare të kombësisë shqiptare dhe të gjuhës shqipe”, për themelimin e shkollës së pavarur kombëtare, duke e shpallur gjuhën shqipe si “gjuhë mësimi në të gjitha shkollat shtetërore”. Pjesë e këtij programi ishin edhe kërkesa për emërimin e nëpunësve shqiptarë në administratën e të gjitha vilajeteve shqiptare, zgjedhja e organeve lokale dhe zgjerimi i kompetencave të tyre, kryerja e shërbimit ushtarak në Shqipëri nën komandën e oficerëve shqiptarë, çka do të çonte në formimin e ushtrisë shqiptare. Parashikoheshin një varg masash që do ta futnin vendin në rrugën e zhvillimit ekonomik dhe do ta çonin përpara industrinë e bujqësinë shqiptare.

Një nga kërkesat më të rëndësishme në fushën e arsimit kombëtar ishte ajo e themelimit të një universiteti shqiptar, që ishte një ëndërr e mendjeve më të ndritura të kombit tonë, e cila u përpunua sërish në Kongresin e Manastirit të vitit 1908 dhe do të bëhej realitet me luftën dhe mundin e intelektualëve dhe të popullit shqiptar vetëm pas disa dhjetëra vjetësh: më 1957, kur u themelua (pasi ishin ngritur institutet e larta pedagogjike në vitin 1946) Universiteti i Tiranës dhe më 1970, kur, pas përpjekjeve dhe kërkesave masive të intelektualëve dhe të të rinjve

¹¹ *HHSSt.A, PA, A.*, Informacion i konsullit austriak në Manastir, 30 nëntor 1908. Shih edhe: “Ç’lipset të kërkojmë nga deputetët shqiptarë?”, në gazetën *Korça*, Korçë, nr. 6, 18 shkurt 1909.

shqiptarë të Kosovës, u themelua Universiteti i Prishtinës në gjuhën shqipe. Shqiptarët e Maqedonisë për një kohë arritën të merrnin arsim të lartë në gjuhën amtare shqipe në kuadër të një Akademie Pedagogjike dhe në një Katedër të gjuhës shqipe pranë Universitetit të Shkupit. Ndërsa në vitin 1994, me nismën e intelektualëve dhe me përkrahjen e popullit shqiptar, u themelua Universiteti i Tetovës, që përbën një nga arritjet më të rëndësishme të shqiptarëve të Maqedonisë së sotme në lëmin e arsimit kombëtar. Njohja e Universitetit të Tetovës nga Qeveria e Maqedonisë, duke e përfshirë në sistemin e arsimit shtetëror, përbën një sukses të popullsisë shqiptare në Maqedoni, ndërsa ngritja në Shkup, në vitin 2007, si institucion kërkimor-shkencor, e “Institutit për trashëgimi kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve”, do t’i japë një shtysë të mëtejshme studimit të trashëgimisë historike-kulturore të popullsisë shqiptare në Maqedoni.

Alfabeti i përbashkët dhe përpunimi i një gjuhe letrare të njësuar me vendimet e Konsultës gjuhësore të Prishtinës të vitit 1968 e sidomos me vendimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, që u mbajt në Tiranë në nëntor të vitit 1972, ushtrojnë një ndikim të fuqishëm në zhvillimin kulturor dhe shpirtëror unitar të shqiptarëve, i ngrenë shqiptarët dhe kombin tonë mbi dallimet dhe veçoritë krahinore, të cilat, me pasurinë dhe larminë e tyre, ndikojnë, pa asnjë mëdyshje, në pasurimin e zhvillimin e mëtejshëm të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në tërësi. Ato dëshmojnë për aspiratat e shqiptarëve për të mënjeluar faktorët divergjentë e për të qenë të bashkuar shpirtërisht, për të pasur një zhvillim kulturor të përbashkët, të mbështetur në një alfabet të njëjtë dhe në një gjuhë të njësuar letrare.

